



# *Shenjat e gishtave dhe Eurodac*

©iStockphoto / Janp013

Informacion për shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi, të kapur për kalim të parregullt të një kufiri të jashtëm, sipas nenit 29(3) të rregullores së (BE) Nr. 603/2013

Nëse ju jeni 14 vjeç e sipër dhe jeni kapur duke kaluar një kufi në mënyrë të parregullt, shenjat tuaja të gishtave do të merren dhe transmetohen tek një bazë të dhënash për shenjat e gishtave e quajtur "Eurodac". Ju duhet të bashkëpunoni me këtë procedurë – ju jeni të detyruar nga ligji të jepni shenjat tuaja të gishtave.

Nëse shenjat tuaja të gishtave nuk janë të një cilësie të qartë, përfshirë nëse ju me dashje i keni dëmtuar gishtat, shenjat e gishtave mund t'ju merren përsëri në të ardhmen.

Nëse në një moment në të ardhmen ju aplikoni përsëri për azil, shenjat tuaja të gishtave do ju merren përsëri. Nëse ju aplikoni për azil në një vend të ndryshëm nga ai ku juve fillimisht ju morën shenjat e gishtave, ju mund të dërgoheni mbrapsht në vendin ku ju morën fillimisht shenjat e gishtave.

Të dhënat e shenjave tuaja të gishtave do të ruhen për 18 muaj – pas 18 muajsh, ato do të fshihen automatikisht nga baza e të dhënave. Vetëm shenjat tuaja të gishtave dhe gjinia do të ruhen në Eurodac – emri, fotografia, ditëlindja dhe kombësia nuk dërgohen ose ruhen në bazën e të dhënave.

Ju mund të kërkonte në çdo kohë në të ardhmen t'ju komunikohet rreth të dhënave që lidhen me ju dhe që janë të ruajtura në Eurodac nga vendi që mori shenjat tuaja të gishtave. Ju mund të kërkonte që të dhënat të korrigjohen ose të fshihen – ato duhet të shuhen nëse ju bëheni, për shembull, qytetar i BE ose një vendi të asociuar, ose nëse ju merrni një leje qëndrimi në një nga këto vende, dhe nuk keni aplikuar për azil.

Eurodac operohet nga një Agjensi e Bashkimit Europian e quajtur eu-LISA. Të dhënat tuaja mund të përdoren vetëm për qëllime të identifikuar nga ligji. Vetëm Sistemi Qendror i Eurodac do të marrë të dhënat tuaja. Nëse ju kërkonte azil në të ardhmen një një tjetër vend të BE ose vend të asociuar<sup>1)</sup>, shenjat tuaja të gishtave do të dërgohen në atë vend për verifikim.

---

1) **Të dhënat tuaja të shenjave të gishtave mund të shkëmbehen, kur e lejon ligji, ndërmjet 28 Shteteve Anëtare të BE plus 4 Vendet e Asociuara – Norvegjisë, Islandës, Zvicrës dhe Litenshteinit.**

Të dhënat e ruajtura në Eurodac nuk do të ndahen me asnjë vend ose organizatë tjetër jashtë BE dhe vendeve të asociuara.

Që nga 20 Korriku i 2015, shenjat tuaja të gishtave mund të kërkohen nga autoritetet si policia dhe zyra Europiane e policisë (Europol), i cili mund të kërkojë të drejtë hyrjeje në bazën e të dhënave të Eurodac për qëllimin e parandalimit, zbulimit dhe hetimit të krimeve të rënda dhe terrorizmit.

Shenjat tuaja të gishtave mund të kërkohen nga autoritetet si policia dhe zyra Europiane e policisë (Europol), i cili mund të kërkojë të drejtë hyrjeje në bazën e të dhënave të Eurodac për qëllimin e parandalimit, zbulimit dhe hetimit të krimeve të rënda dhe terrorizmit.

## Informacion Kontakti

Identiteti dhe detajet e kontaktit të kontrollorit të Eurodac

### Departamenti i Migracionit nën Ministrinë e Punëve të Brendshme

L. Sapiegos str. 1, 10312 Vilnius

Tel: +370 5 271 7112

Email: md.rastine@vrm.lt

<http://www.migracija.lt>

Detajet e Autoritetit Kombëtar Mbikqyrës (për mbrojtjen e të dhënave)

### Inspektorati Shtetëror për Mbrojtjen e të Dhënave

A. Juozapavičiaus str. 6, 09310 Vilnius

Tel: +370 5 271 2804, +370 5 279 1445

Email: [ada@ada.lt](mailto:ada@ada.lt)

<https://www.ada.lt>

©Bashkimi European 2014

Autorizohet riprodhimi. Për çdo përdorim ose ri-prodhim të fotove individuale leja duhet kërkuar direkt nga mbajtësit e të drejtës së autorit.

doi:10.2847/19995

ISBN 978-92-9243-157-0

